



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 126 /2011

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës 03/L-040 nenin 12, neni 40, Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 neni 20, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149 neni 44, Rregulloren e punës së Kuvendit neni 15. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më datë: 23.11.2011 mori:

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KOMPENZIMIN E UDHËTIMEVE ZYRTARE DHE PAGESËN E MËDITJEVE

I

Miratohet Rregullorja me numër **01/Nr.126/2011** me tekstin e mëtejme (Rregullorja për Kompensimin e Udhëtimeve dhe Pagesën e Mëditjeve .

II

Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të Komunës, kjo rregullore rregullon çështjet e udhëtimeve zyrtare si dhe mëditjet për këto udhëtime brenda dhe jashtë shtetit për të siguruar një përdorim ekonomik dhe efikas të mjeteve financiare të komunës.

III

Rregullorja është hartuar nga Drejtoria për Administratë, përmban gjithsej 18 nene dhe është pjesë përbërëse e këtij Vendimi

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit

V

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria e Administratës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 30.11.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlashi

